



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Akademia e Shkencave

Kryesia

Prot. 207  
Dt. 03.03.2020

## **Rregullore për ceremonialin në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë**

Në mbështetje të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* (më tej: ASHSH) dhe të nenit 60 të Statutit të saj, ceremoniali zyrtar i këtij institucioni ndërtohet si në vijim:

### **Neni 1 Objekti**

Kjo rregullore përcakton veprimtaritë ceremoniale që zhvillon ASHSH, mënyrën e organizimit të ceremonive dhe solemnitetin e veprimtarive kryesore të saj.

### **Neni 2 Veprimtaritë ceremoniale**

Veprimtaritë ceremoniale që organizon ASHSH janë:

1. Marrja e detyrës prej Kryetarit të ASHSH;
2. Dorëzimi i diplomave të pranimit të anëtarëve të rinj në ASHSH;
3. Dorëzimi i diplomave të fituesve të çmimeve shkencore që jepen nga ASHSH;
4. Kremtimi i përvjetorëve të anëtarëve të Asamblesë dhe/apo figurave të tjera të shquara të shkencës e dijes;
5. Veprimtaritë në nderim të akademikëve të ndarë nga jeta;
6. Pritjet e delegacioneve të huaja;

7. Të gjitha rastet kur pritjet e personaliteteve dhe delegacioneve të huaja parashihen në ligjin dhe aktet nënligjore për Protokollin e Shtetit.

### Neni 3

#### Detyrat për organizimin e ceremonialit

Përgjegjësitë administrative për përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e ceremonive në ASHSH janë të sekretarit shkencor, kancelarit dhe sektorit të marrëdhënieve me jashtë dhe publikun, si në vijim:

1. Përgatisin, organizojnë dhe ndjekin zhvillimin e ceremonisë;
2. Bashkëpunojnë me protokollin e shtetit dhe shërbimet e protokollit të institucioneve të tjera për realizimin e ceremonialit sipas pikës 6, neni 2;
3. Drejtimin e ceremonialit për pikat 1, 2, 3 të nenit 2 të kësaj rregullorje e kryen sekretari shkencor, ndërsa për pikat 4, 5, 6 e kryen kancelari.

### Neni 4

#### Mjediset e organizmit të ceremonialit

1. Veprimtaritë ceremoniale të ASHSH zhvillohen sipas rastit, të hapura apo të brendshme;
2. Veprimtari ceremoniale të ASHSH mund të organizohen edhe në institucione të tjera dhe në mjedise jashtë institucionit;
3. Vendi i organizmit të ceremonisë caktohet nga Kryesia.

### Neni 5

#### Solemniteti

Veprimtaritë ceremoniale të Asamblesë dhe veprimtaritë e të tjera kryesore të ASHSH zhvillohen sipas solemnitetit të mëposhtëm:

1. Veshja formale e anëtarëve të Asamblesë është sipas uniformës zyrtare të përshkruar me fjalë dhe foto në *Shtojcën 1* të kësaj rregullorje. Uniformat realizohen nga ASHSH dhe administrohen prej saj;
2. Në sallë qëndrojnë dukshëm flamuri kombëtar, flamuri me logon e ASHSH dhe flamuri me logon e ALLEA-s;
3. Vendet e qëndrimit në sallë të anëtarëve të Asamblesë janë sipas rendit alfabetik. Në rreshtin e parë rezervohen deri në 7 vende nga Kryesia për personalitete të ftuar sipas veprimtarisë. Sektori i marrëdhënieve me

jashtë dhe publikun shenjon në çdo ndenjese emrin e personit që i rezervohet. Të ftuarit qëndrojnë në vendet e caktuara për ta;

4. Veprimtaritë ceremoniale hapen me himnin kombëtar;
5. Veshja e nëpunësve pjesëmarrës në veprimtari është formale.

#### Neni 6

#### Diplomat e titujve akademikë

Diploma jepet për çdo pranim të ri apo avancim në titull akademik, si dhe për çdo titull tjetër të përcaktuar në Ligj e Statut:

1. Për titullin *Akademik* jepet diploma sipas *Shtojcës 2*, bashkëlidhur;
2. Për titullin *Akademik i asociuar* jepet diploma sipas *Shtojcës 3*;
3. Për titullin *Anëtar i jashtëm* jepet diploma sipas *Shtojcës 4*;
4. Për titullin *Anëtar nderi* jepet diploma sipas *Shtojcës 5*;
5. Për titullin *Anëtar Emeritus* jepet diploma sipas *Shtojcës 6*;
6. Diplomat nënshkruhen nga Kryetari dhe sekretari shkencor dhe përmbajnë numër amze, logon e ASHSH, dhe vulën e saj. Ato regjistrohen në librin e anëtarëve me titujve akademikë, që ruhet nga sekretaria e Kryesisë së ASHSH. Diploma shoqërohet me medalionin përkatës sipas përshkrimit në *Shtojcën 7*.

#### Neni 7

#### Fillimi i detyrës nga Kryetari i Akademisë së Shkencave

Kryesia e ASHSH organizon në mjediset e saj mbledhjen e hapur të Asamblesë, në të cilën ftohen të marrin pjesë titullarë e përfaqësues të institucioneve kërkimore-shkencore e arsimore, si dhe autoritete publike të jetës së vendit. Ceremonia zhvillohet sipas këtij rendi:

1. Emërimi i Kryetarit të ASHSH shpallet nga Presidenti i Republikës. Në rast të mospranisë së tij emërimi bëhet publik nga anëtari më i vjetër i Asamblesë;
2. Bëhet dorëzimi simbolik i detyrës nga Kryetari paraardhës;
3. Kryetari i zgjedhur i drejtohet Asamblesë me një fjalë përshëndetëse;
4. Ceremonia mbyllet me foto protokollare dhe koktejl mikpritjeje.

## Neni 8

### Pranimi i anëtarëve të rinj

1. Kryesia e ASHSH organizon mbledhje të hapur të Asamblesë, në të cilën ftohen të marrin pjesë bashkëpunëtorë e kolegë të anëtarit/anëtarëve të rinj, si dhe përfaqësues të institucioneve publike e kërkimore;
2. Anëtari/anëtarët e rinj qëndrojnë në një vend të përcaktuar, përballë trupës së Asamblesë;
3. Anëtari/anëtarët e rinj paraqesin sipas rendit alfabetik ligjëratën akademike dypjesëshe, që zgjat 10-15 minuta. Në pjesën e parë anëtari / anëtarët e rinj spikasin rëndësinë e veprës së akademikëve paraardhës të ndarë nga jeta; ndërsa në pjesën e dytë paraqiten rezultatet e arritura nga anëtari / anëtarët e rinj dhe qëllimet shkencore pas marrjes së titullit;
4. Akademiku më i moshuar shpërndan diplomatat dhe fton anëtarin/anëtarët e rinj të zënë vend në ndenjset e rezervuara, sipas rendit alfabetik.

## Neni 9

### Akademikët Emeritus

Ceremoniali për anëtarët *Emeritus* është e njëjta si në nenin 8, me përjashtimin që diplomatat e tyre dorëzohen nga Kryetari i ASHSH.

## Neni 10

### Dhënia e çmimeve shkencore.

Ceremonia për ndarjen e çmimeve shkencore që jepen nga ASHSH organizohet sipas këtij rendi:

1. Kryesia e ASHSH organizon mbledhjen e hapur;
2. Fjalën e hapjes e mban përfaqësuesi i ngarkuar nga Kryesia;
3. Përfaqësuesi i jurisë shpall motivacionet për veprat e nomonuara;
4. Kryetari i jurisë shpall fituesit;
5. Fituesi/fituesit ftohen për t'u dorëzuar diplomatat e çmimit. Dorëzimi bëhet prej personaliteteve të caktuar nga Kryesia;
6. Fituesi/ fituesit mbajnë një fjalë të shkurtër përshëndetëse;
7. Momenti festiv dokumentohet përmes fotove dhe filmimeve nga sektori përkatës.

## Neni 11

### Nderimet në rastin e ndarjes së akademikut nga jeta

Në rastin e ndarjes nga jeta të një anëtari të Asamblesë organizohet ceremoni nderimi si vijon:

1. Seksioni shkencor përkatës përgatit nekrologjinë, që publikohet në faqen zyrtare të institucionit e në rrjetet sociale të saj. Nekrologjia dërgohet në mediat kombëtare televizive, të numerizuara dhe në shtyp;
2. Në nderim të të ndjerit organizohet një akademi solemne, në të cilën kolegët dhe miqtë evokojnë kontributet dhe vlerat njerëzore e qytetare të tij para një audience të përbërë nga bashkësia shkencore e familjarët;
3. Homazhet zhvillohen në ambientet e ASHSH, në sallën e përshtatur në dy pjesë: nga *e majta*, qendrojnë familjarët e të afërmit dhe nga *e djathta* anëtarët e Asamblesë dhe kolegët. Ceremonia nis me vendosjen e një kurore me lule në emër të ASHSH nga Kryesia, nën tinguj funebër;
4. Shiritat e zisë vendosen në krahun e majtë të të pranishmëve në homazhe. Personat e ngarkuar për këtë caktohen nga kancelari;
5. Gjatë homazheve në një kënd të dukshëm vendoset libri i nderimeve dhe botimet kryesore të të ndjerit. Personalitete dhe vizitorë shenjojnë përshtypjet dhe vlerësimet e tyre në nderim të tij;
6. Pas homazheve, në oborrin e ASHSH mbahet fjalimi i përmortshëm kushtuar vlerave të jetës dhe veprës së akademikut të ndarë nga jeta;
7. Në faqen zyrtare të institucionit jetëshkrimi i akademikut të ndjerë vendoset në linkun *Akademikë të ndarë nga jeta*.

## Neni 12

### Pritjet e delegacioneve të huaja

Ceremonia e pritjes së delegacioneve të huaja zhvillohet si vijon:

1. Delegacioni pritët në aeroport ose në kufirin tokësor nga përfaqësuesi i ngarkuar nga Kryesia, i cili bën shoqërimin dhe vendosjen në hotel;
2. Delegacioni pritët në oborrin e ASHSH nga Kryetari apo një përfaqësues i Kryesisë, si dhe nga specialisti i marrëdhënieve me jashtë. Delegacioni shoqërohet në zyrën e Kryetarit;
3. Në mjedisin e takimit zyrtar vendosen dukshëm shenjat akademike dhe flamujt kombëtarë të Shqipërisë dhe të vendit që përfaqëson delegacioni akademik i ftuar;

4. Bisedimet zhvillohen sipas programit të miratuar paraprakisht. Proces verbali mbahet nga sekretarja e Kryesisë;
5. Në përfundim shkëmbehen dhurata dhe bëhen foto ceremoniale;
6. Delegacioni shoqërohet nga nëpunësi i sektorit të marrëdhënieve me jashtë dhe nga një përfaqësues i Kryesisë;
7. Ambientet jashtë dhe brenda institucionit zbukurohen sipas rastit.

### Neni 13

#### Pritjet sipas Protokollit të Shtetit

Pritjet e rekomanduara nga Protokollin e Shtetit bëhen sipas ligjit që rregullon këto pritje. Përveç kësaj, për aktivitetet e përfshira në kalendarin e vizitave të parashikuara në Protokollin e Shtetit, shtohen veprimet e parapara në nenin 12 të kësaj rregullorje, duke përfshirë ndryshimin që në ambientet e jashtme delegacioni pritët nga Kryetari ose zëvendëskryetari dhe përcillet prej tyre deri jashtë institucionit.

Miratohet:

Kryetari

  
AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI



Kjo rregullore u miratua në parim me vendimin nr. 18, në mbledhjen e datës 21 shkurt 2020 të Asamblesë së ASHSH.